

VENDIM
Nr. 614, datë 1.11.2023

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 419, DATË 7.7.2023, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E FUSHAVE DHE NËNFUSHAVE
PRIORITARE TË ZHVILLIMIT TË VENDIT DHE TË SHITESËS SË VEÇANTË
TË KUSHTËZUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “d” e “dh”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 419, datë 7.7.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit dhe të shtesës së veçantë të kushtëzuar”, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas shkronjës “b”, të pikës 1, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:
“c) inovacioni dhe implementimi i teknologjive të përparuara, përmes hartimit dhe zbatimit të politikave, në sektorët e lidhur me inovacionin.”.

b) Në pikën 2, pas fjalëve “... dhe në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ...” shtohen “... dhe në Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës ...”;

c) Në lidhjen nr. 1 shtohet tabela që i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare të këtij vendimi:

a) për titullarin e Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës fillojnë nga momenti i emërimit të tij në detyrë dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e Kryeministrit;

b) për nëpunësit e tjerë të Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës fillojnë nga data 1 janar 2024 dhe përballohen nga fondet e miratuara për këtë institucion.

3. Ngarkohen Kryeministria dhe Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtesa e veçantë e kushtëzuar për nëpunësit në Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës

Pozicioni	Shtesa e veçantë e kushtëzuar (lekë/muaj)
Titullar institucioni.	92 000
Zëvendëstitullari institucioni. Drejtues qendre.	65 000
Ekspert.	30 000